



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:124086
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05721226

AA.nr.470/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit K.(Xh.) K., nga Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.B., avokat në Gj., kundër të paditurit/kundër propozuesit Ministria e Drejtësisë, me bazë juridike anulim vendimi, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit - paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1043/23, të datës 01.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit K. K., e datës 11.12.2023, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1043/23, i datës 01.12.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është hedhë si i palejueshëm propozimi i propozuesit, K. K., me të cilën ka kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i shpalljes publike për dhënien e provimit të noterisë i datës

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit - propozuesit, duke e kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar, përkatësish jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar

të së drejtës material, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Paditësi/ propozuesi, kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, ka parashtruar padi lidhur me anulimin e konkursit/shpalljes publike për dhënien e provimit të noterisë të datës

Gjykata e shkallës së parë, për të vlerësuar ligjshmërinë e propozimit për shtyrje të konkursit, përkatësisht shpalljes publike, i'u referua dhe nenit 13, nenit 14 të LKA-së.

Kështu në rastin konkret propozuesi mund të kërkojnë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtar apo vendimit të shkallës së parë në rast të heshtjes administrative por jo dhe shtyrjen e konkursit të dt...., meqë konkursi nuk është akt administrativ lidhur me të cilin mund të iniciohet konflikti administrativ dhe për të cilën mund të kërkohet shtyrja e ekzekutimit të tij në kuptim të nenit 13 paragraf, 1 dhe 2 dhe 14 të Ligjit të Konflikeve Administrative (LKA-së).

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 23.2 dhe 49 të LKA, lidhur me nenin 194 të LPK-së, (Ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), dhe as me shkelje të tjera sipas pretendimeve në ankesë. Kolegji, njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se propozimi i paditësit sipas përmbajtjes së tij nuk është i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 22 të LKA, i cili e rregullon mënyrën e parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e vendimit përfundimtar të organit administrativ deri në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë. Nga përmbajtja e propozimit nuk kërkohet pezullimi i asnjë akti administrativ përfundimtar, ashtu si parashihet me këtë dispozitë dhe nuk arsyetohet në këtë drejtim, mirëpo me propozim ka kërkuar anulimin e konkursit të datës ..., i cili nuk është akt përfundimtar administrativ.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i Gjykatës së Apelit, njëjtë si edhe gjykata e shkallës së parë, vlerëson se në këtë çështje nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të filluar procedura e shqyrtimit të çështjes në procedurë gjyqësore, të konfliktit administrativ, sipas dispozitave të nenit 13 të LKA-së i cili nen përcakton se: “1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”, për shkak se paditësi me propozim nuk e konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, kundër të cilit ka mundur të hapet konflikti administrativ, për tu vlerësuar ligjshmëria e tij ashtu siç parashihet me nenin 9 të LKA-së, por me propozimin e datës 15.11.2023, dhe me plotësimin e padisë, të datës 29.11.2023, paditësi ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të shpalljes publike për Dhënien e Provimit të Noterisë të datës 01.11.2023, të paditurës MD deri në marrjen e vendimit definitiv nga gjykata.

Theksimet në ankesë të cekura si më lartë dhe të tjerat, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore, dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, sepse paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ofron dëshmi që ka vepruar në baza ligjore sipas dispozitave të LKA-së, të cekura më lartë për fillimin e procedurës

gjyqësore të konfliktit administrativ, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë, me që paditësi nuk e konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, e hedhë poshtë propozimin për masë si në vështrim të nenit 34 par.1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 9 të LKA-së, si të palejueshme.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA dhe neni 209, pika.b) i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.470/2024, me datë 21.05.2024

Kryetare e Kolegjit,
Delushe Halimi